

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË “REGAN” Sh.p.k

KAPITULLI I

NENI 1

Në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" me vullnetin tim të lirë, si themelues dhe ortak i vetëm i shoqërisë kam rënë dakord të hartoj këtë Statut dhe Akt themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) "**REGAN**" SHPK, e cila do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi e themeluar nga **Z. Barlet Dede** si vijon:

Z. Barlet Dede, me shtetësi shqiptare, i datëlindjes 20.09.1988, lindur në Progër, banues në Tiranë, identifikuar me Pasaportë Nr.BB1240560 dhe ID I80920024H.

Deklaroj se sot më datë 19.02.2025, kam nënshkruar këtë statut dhe akt themelimi për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të këtij statuti dhe akti themelimi duke respektuar kërkesat e legjislacionit shqiptarë për shoqëritë tregtare.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet "REGAN" (në vijim: Shoqëria)

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k.)

Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj zyrtare.

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria "REGAN" Shpk do të ketë selinë e saj në Rrugën "Abdyl Frashëri, Pallati Nr.6, Kati 3, Tiranë, 1001.

NENI 4

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të pacaktuar.



NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet në fushën e ndërtimit, mjedisit dhe eficiencës energjetike, duke përmbyllur objektet e mëposhtme:

Hartimin i Projekteve

- Projekte të fizibilitetit dhe projekte të detajuara arkitektonike, strukture, gjeoteknike, gjeologjike, mjedisore dhe të impianteve elektrike dhe mekanike për:
 - Ndërtesat rezidenciale dhe trëgetare.
 - Banesa individuale dhe komplekse apartamentesh.
 - Qendra tregtare, zyra dhe ndërtesa biznesi.
 - Aplikime për fondet e BE dhe/apo të tjetër donator
 - Ndërtesa publike, si shkolla, spitale dhe universitete.
- Infrastrukturat Ujore
 - Sisteme ujësjellësi dhe kanalizimi.
 - Diga dhe rezervuarë uji.
 - Përmirësimi dhe pastrimi i ujërave.
- Rugë dhe sinjalistika
 - Autostrada, rrugë rajonale dhe lokale.
 - Sinjalistika e autostradave, rrugëve rajonale dhe lokale.
 - Sinjalistika Rrugore vertikale dhe horizontale
 - Ura dhe tunele
 - Hekurudha, stacione treni, aeroporte dhe porte detare.
- Ndërtime Industriale
 - Fabrika dhe impiante prodhimi.
 - Depo dhe magazina të mëdha.
 - Ndërtesa për shërbime logjistike.
- Infrastrukturat Energjetike
 - Termocentrale dhe hidrocentrale.
 - Linja elektrike dhe stacione elektrike.
 - Energji e rinovueshme (parqe diellore dhe eolike).
- Ndërtime për Zhvillimin Urban
 - Sheshe publike dhe parqe.
 - Ndriçimi dhe rrjete shërbimesh publike.

- Kanalizime dhe drenazhe për menaxhimin e ujërave të shiut.
- Ndërtime të Veçanta
 - Stadione sportive dhe arena.
 - Teatrot dhe ndërtesa kulturore.
 - Monumentet dhe ndërtesa historike.

Zbatimi, Mbikëqyrja dhe Kolaudimi i Projekteve

- Zbatimi dhe kontrolli cilësor i projekteve arkitektonike, strukturore, dhe të impianteve për:
 - Të gjitha llojet e ndërtesave dhe infrastrukturave të sipërpërmendura.

Mirëmbajtja e Veprave Ndërtimore

- Mirëmbajtje e zakonshme dhe e jashtëzakonshme për:
 - Të gjitha kategoritë e ndërtesave dhe infrastrukturave të sipërpërmendura.

Shërbime Konsulence

- Konsulencë në fushat e inxhinierisë së ndërtimit (strukturore, transport, gjeoteknike, etj.) dhe asaj mjedisore.
- Konsulencë Mjedisore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ndryshimeve të klimës dhe adoptimit të ekosistemeve.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe hartimi i planeve të menaxhimit mjedisor.
- Kontrolli dhe monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës.

Zhvillimi i Energjisë së Rinovueshme

- Hartimi i projekteve për energji të qëndrueshme dhe zgjidhje ekologjike.

Menaxhimi i Pasurive të Paluajtshme

- Zhvillimi, administrimi dhe shitja e projekteve të pasurive të paluajtshme.
- Ndërmjetësim për transaksione të pronave.

Aftësimi dhe Trajnimet

- Organizimi i kurseve profesionale në ndërtim, eficiencë energjie, mjedis dhe turizëm të qëndrueshëm.
- Certifikimi i aftësive profesionale për sektorin e ndërtimit.

Aktivitete Ndihmëse

- Punime gjelbërimi dhe rehabilitimi mjedisor.
- Konsolidim i tokës dhe ndërhyrje gjeoteknike.
- Investime në bashkëpunim me kompani vendase dhe të huaja.
- Zgjidhje për dixhitalizimin e proceseve ndërtimore dhe menaxhuese.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100,000 lekë (njëqind mijë lekë), i përbërë nga 1 kuotë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100,000 lekë.

Z. Barlet Dede zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 lekë (njëqind mijë lekë).

Kapitali mund të rritet ose të zvogëlohet me vendim të asamblesë së ortakëve/ortakut themelues. Kuotat e pjesëmarrësve në kapital janë të emëruara dhe të pandashme. Kapitali është plotësisht i shlyer dhe i nënshkruar. Çdo kuotë përfaqëson të drejtën për një votë.

NENI 7

Meqenëse shoqëria ka vetëm një ortak, Z. Barlet Dede, e drejta për të shitur kuotat nuk mund të ushtrohet ndaj ndonjë ortaku tjetër, pasi nuk ekzistojnë ortakë të tjerë në shoqëri.

Në rastin kur Z. Barlet Dede dëshiron të shesë kuotën e tij të vetme, ai ka të drejtë të përcaktojë lirshëm blerësin dhe kushtet e shitjes, duke qenë se është zotëruesi i vetëm i kapitalit të shoqërisë.

NENI 8

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 9

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarive të shoqërisë.

NENI 10

Duke qenë se shoqëria ka vetëm një ortak, Z. Barlet Dede, heqja dorë nga bashkëpunimi nuk aplikohet për ndonjë ortak tjetër. Megjithatë, në rast të ndonjë ndryshimi në statusin e zotërimit të kapitalit, Z. Barlet Dede nuk do të çlirohet nga detyrimet që kanë lindur para çdo ndryshimi dhe do të vazhdojë të gëzojë të drejtat që janë krijuar para tij.

NENI 11

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë së shoqërisë, të reflektuara në bilancet periodike, i përkasin Z. Barlet Dede si zotëruesi i vetëm i kapitalit, pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga Z. Barlet Dede nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e përcaktuar nga ligji.

NENI 12

Shoqëria është një shoqëri me një ortak të vetëm, Z. Barlet Dede, i cili është përdorues dhe disponues i pasurisë së tij. Ai mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, materiale ose jo materiale, duke përfshirë të drejtën për shitjen e pasurisë së saj tek të tretët.

Në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria gëzon të drejta njësoj si çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 13

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat dhe detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Si ortak i vetëm themelues i shoqërisë, Z. Barlet Dede mban rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku ka pasur përpara krijimit të saj.

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

Kompetencat e ortakut të vetëm

Ortaku i vetëm, Z. Barlet Dede, ka të drejtë të administrojë aktivitetin e shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese që shoqëria mund të kryejë, si dhe vlerat intelektuale dhe ekonomike-financiare të saj. Ai ka të drejtë të marrë dijeni për rezultatet ekonomiko-financiare në çdo fazë të aktivitetit të shoqërisë dhe të marrë pjesë në këto aktivitete personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.

Ortaku i vetëm, Z. Barlet Dede, ka të drejtë të tërheqë të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.

Ortaku i vetëm, Z. Barlet Dede, ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria ose të shesë pjesën e kapitalit në përputhje me kushtet e përcaktuara në statut dhe ligj.

Ortaku i vetëm, Z. Barlet Dede, ka të drejtë të jetë ortak edhe në shoqëri të tjera në përputhje me statutin, aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi.

Ortaku i vetëm, Z. Barlet Dede, rezervon të gjitha të drejtat e përcaktuara nga legjislacioni tregtar.

NENI 15

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Barlet Dede.

NENI 16

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë me qëllim arritjen e objektivave të saj, përveç kompetencave që i takojnë ortakut të vetëm sipas ligjit.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe para organeve administrative dhe gjyqësore.

Administratori është përgjegjës personalisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e ligjit, statutit ose dëmet e shkaktuara gjatë administrimit. Ortaku i vetëm ka të drejtë të ngrejë padi ndaj tij.



Administratori emërohet dhe shkarkohet nga ortakut i vetëm. Ai ka të drejtë të veprojë dhe të firmosë pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe çdo autoriteti tjetër për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

Shoqëria mund të ketë vetëm 1 (një) administrator, i cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin ose dorëheqjen e tyre, për një periudhë maksimale prej 5 vitesh.

Administratori ka të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të kryera për llogari të shoqërisë.

Në rast se administratori rezulton i suksesshëm në drejtimin dhe rezultatet financiare të shoqërisë, ortakut i vetëm mund të vendosë për shpërblimin e tij në fund të vitit financiar

NENI 17

DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- Të administrojë me kujdes pasurinë e shoqërisë.
- Të lidhë marrëveshje me të tretët brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të përcaktuara nga ortakut i vetëm.
- Të zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë.
- Të shlyejë dëmet që shoqërisë mund t'i vijnë nga veprimet ose mosveprimet e tij.
- Të paguhet për punën e kryer në bazë të marrëveshjes me ortakun e vetëm.
- Të marrë të dhëna dhe të bëjë propozime për çështje të dobishme për shoqërinë.
- Të përgatisë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratimin përfundimtar të ortakut të vetëm.
- Të bëjë propozime për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të propozojë krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive brenda dhe jashtë vendit.
- Të përgatisë propozime për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesë ato ortakut të vetëm për miratim.
- Të zbatojë vendimet e ortakut të vetëm dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ai.

NENI 18

EKSPERTI KONTABËL

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tij bëhet nga administratori.

Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë.

Ai përgjigjet për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi

NENI 19

MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 20

MOSMARRËVESHJET

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 21

SEKRETI I PUNËS

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë .Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI IV

VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 22

VITI FINANCIAR

Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Përfundimisht Viti i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.

NENI 23

INVENTARI DHE LLOGARITE VJETORE

Shoqëria do te mbaje një kontabilitet te rregullt të pasurisë dhe te veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

NENI 24

RAPORTET VJETORE

Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortakët.

Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.



NENI 25

REZERVA E DOMOSDOSHME DHE E NEVOJËSHME

Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar, pasi zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, hiqet një shumë e barabartë me 5% të fitimit, e cila destinohet për formimin e fondit rezervë të quajtur “Rezervë e Domosdoshme”.

Kontributi në këtë rezervë pushon së qeni i detyrueshëm kur ajo arrin 10% të kapitalit themeltar. Megjithatë, nëse për çfarëdo arsye kjo rezervë bie nën këtë prag, detyrimi për ta plotësuar rifillon automatikisht.

Ortaku kanë gjithashtu mundësinë të përcaktoj zbritje shtesë në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera. Ai mund të vendos edhe për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 26

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria gjatë çdo viti financiar shpërndahen sipas vendimit të ortakut, duke respektuar detyrimin për të alokuar 5% të tyre në rezervën ligjore.

KAPITULLI V

MBYLLJA E SHOQËRISE, LIKUJDIMI

NENI 27

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentabël gjatë dy viteve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 28

Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaku cakton një likuidator, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria, gjatë likuidimit, mban anash emërtimit dhe emrin “Shoqëri në Likuidim e Sipër”.

Likuidatori i emëruar nga ortaku, menjëherë sapo merr detyrën, është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t’ia vërë menjëherë në dispozicion ortakëve.

Me miratimin e likuidimit, shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 29

Ortaku vendos mbi rregullshmërinë e likuidimit, për të miratuar bilancin e likuidimit dhe për të hequr mandatin e likuidatorit.



Ortakut mund të vendos vetë realizimin e kësaj mbledhjeje, nëse likuidatori nuk e kërkon. Mbledhja mund të caktohet edhe nga gjykata me propozimin e ortakëve ose të një mandatarbajtësi të caktuar prej saj.

NENI 30

Kur ortakut, për shkaqe të arsyeshme, nuk vendos për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes së likuidimit dhe depozitimi i dokumentacionit në regjistrin tregtar bëhen nga shoqëria, e cila çregjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 31

Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për efekt të interpretimit të këtij Statuti, me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare".

Pavlefshmëria eventuale e dispozitave të veçanta të Statutit nuk cenon vlefshmërinë e tij.

NENI 32

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 33

Ky Statut dhe akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga ortakut.

**ORATAKU THEMELUES I
SHOQËRISË**

"REGAN" SHPK

BARLET DEDE

Barlet Dede

